

Mbi trajnimin për forcimin e kapaciteteve audituese, për auditimin e koncesioneve dhe Partneritetit Publik Privat, Projekti SECO

Më datë 16.09.2024, në ambientet e Hotel Plaza, u mbajt trajnimi mbi kuptimin dhe zbatimin e manualit të auditimit të koncesionit/PPP, në kuadër të projektit “Forcimi i kapaciteteve profesionale të KLSH-së në auditimin e kontratave koncesionare dhe partneriteteve publike private në Shqipëri”. Ky projekt, i financuar nga Sekretariati Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO) i Zvicrës, ka si qëllim ndërtimin e kapaciteteve në auditimin e kontratave të Koncesionit dhe formave të tjera të Partneritetit Publik Privat (PPP).

Projekti, i zbatuar nga RSM Kosova në bashkëpunim me RSM Albania, ka mbështetur planifikimin dhe zbatimin e 3 (tre) auditimeve pilot për 3 (tre) kontrata koncesionare dhe/ose PPP të përzgjedhura nga KLSH, mbështetje e cila u ofrua në të gjitha fazat dhe proceset e auditimit. Gjithashtu, përfshiu zhvillimin e metodologjisë së auditimit të koncesionit/PPP, si dhe trajnimin e ekipeve të auditimit të caktuar për secilin nga pilotët e përzgjedhur.

Trajnimi i mbajtur nga RSM Albania dhe RSM Kosova, organizuar në bashkëpunim me KLSH, u bazua kryesisht në manualin e auditimit të koncesionit/PPP, i cili paraqet të gjitha proceset dhe teknikat e auditimit të përdorura për auditimin e kontratave të koncesionit/PPP, sikurse identifikohen nga praktikat më të mira dhe rekomandohen nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI). Ndër objektivat kryesore të këtij trajnimi renditen:

- Rritja e të kuptuarit të auditimit të kontratave të koncesionit/PPP, që do të ndihmojë audituesit në punën e tyre, veçanërisht me gjetjet dhe rekomandimet e auditimit.
- Përmirësimi i performancës së funksioneve të mbikëqyrjes së koncesionit/PPP nga institucione si Parlamenti dhe Komisioni i Përhershëm i Ekonomisë dhe Financave.
- Forcimi i kapaciteteve për të identifikuar dhe adresuar boshllëqet në praktikat e auditimit të kontratave koncesionare/PPP, duke çuar në një mbikëqyrje dhe llogaridhënie më efektive.
- Aftësi të përmirësuara në interpretimin dhe përdorimin e metodave dhe teknikave të praktikave më të mira në auditimin e kontratave të koncesionit/PPP për të ofruar gjetje dhe rekomandime të informuara për të ardhmen.

